

VIHET NË DYSHIM FUNKSIONALITETI I KËSHILLIT TË SIGURISË NË LIPJAN

Bojkotohet mbledhja e KKSB-së për mospagesë mëditjesh

Injorimi i bërë nga organet komunale, përkatësisht Zyra e personelit për të paguar mëditjet për kontributin e anëtarëve të KKSB-së, sipas Bekim Krasniqit, drejtor ekzekutiv i Asociacionit Rinor për të Drejtat e Njeriut (YAHR) është bërë sebeb i një bojkoti në mënyrë demonstrative

Arian Duriqi



LIPJAN, 29 QERSHOR – Ajo që ishte paralajmëruar edhe ngjau. Është bojkotuar mbledhja e fundit të Këshillit komunal të sigurisë në bashkësi (KKSB) për shkakun e mospagesës e mëditjeve ndaj anëtarëve të këtij organi, ani pse pagesa është e rregulluar edhe me një Udhëzim administrativ nga Ministria e Punëve të Brendshme që nga shtatori i vitit 2012.

E, injorimi që është bërë nga organet komunale, përkatësisht Zyra e personelit për të paguar mëditjet për kontributin e anëtarëve të KKSB-së, sipas Bekim Krasniqit, drejtor ekzekutiv i Asociacionit Rinor për të Drejtat e Njeriut (YAHR) është bërë sebeb i një bojkoti në mënyrë demonstrative.

“Anëtarët e KKSB-së, të gjithë ata që s’marrin paga nga buxheti i shtetit siç është paralajmëruar më herët edhe publikisht nuk pranojnë më të dalin në mbledhje, por do t’i bashkohen bojkotit, i cili do të mbarojë vetëm atëherë kur të jepen

mëditjet”, ka thënë ai.

“Dhe, meqë tashmë edhe Udhëzimi administrativ e rregullon punën e mëditjeve, kemi kërkuar të realizohen të drejtat e anëtarëve para se të shfaqet rreziku për mosfunksionim të organit. Si duket autoritetet komunale, bashkë me Zyrën e personelit që është përgjegjëse për këtë punë nuk i kanë realizuar mëditjet, sepse nuk i kanë besuar një bojkoti, por kjo është një punë që parashihet të paguhet nëpërmjet një Udhëzimi administrativ nga MAPL-ja”, ka sqaruar arsyet e bojkotit, Krasniqi, i cili është anëtar i KKSB-së.

Edhe anëtari tjetër i KKSB-së, Zoran Rodiq, ka kërkuar pagesë mëditjesh, në qoftë se duan ta mbajnë gjallë KKSB-në.

“Jam interesuar dhe jam njoftuar se në Graçanicë për shembull i paguajnë mëditjet. Dhe, tashmë po pyes si ka mundësi që në Graçanicë dhe në disa komuna të tjera t’u paguhet mëditjet anëtarëve të KKSB-së, e në Lipjan jo”, ka pyetur ai.

Ndërkohë, Haqif Rustemi, shef i Shërbimit të zjarrfikësve në Lipjan, po ashtu anëtar i KKSB-së, ka deklaruar me këtë rast se meqë Kuvendi është themeluar i KKSB-së, do të duhej që KK-ja të marrë përsipër pagesën e mëditjeve.

“Shumë komuna i paguajnë mëditjet dhe nuk kanë vështirësi në këtë plan. Duhet të pajtohemi se faji me këtë rast është te faktori njeri dhe kështu po ngec pagesa e mëditjeve. Meqë Kuvendi e ka themeluar këtë trupë, atëherë është lehtë të nxirret konstatimi se kush duhet t’i paguajë mëditjet”, ka thënë ai.

E, kryesuesi i mbledhjes së fundit të KKSB-së, Florent Hoxha, ka premtuar se do të shikohen praktikat e komunave e të tjera si e kanë gjetur mënyrën e pagesës, në mënyrë që edhe Lipjani ta aplikojë të atë. “Duhet shikuar mundësinë reale të pagesës, si kjo po funksionon edhe në komuna të tjera, për ta mbajtur gjallë KKSB-në”, ka thënë Hoxha.